

**UDHËZIM**  
**Nr.1957, datë 19.9.2006**

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.619, DATË 7.9.2006 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.619, datë 7.9.2006 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 “Për përcaktimin e pagës minimale për vitin 2006”,

**UDHËZOJ:**

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 1 germa “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.619, datë 7.9.2006 është 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.  
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektin nga 1.9.2006.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
**Koço Barka**